




# ANALIZA E SEKTORIT TË PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE



**SIRE**  
Sustainable and Inclusive  
Rural Economic Development

**CARITAS** Schweiz  
Suisse  
Svizzera  
Svizra

With funding from  
 **Austrian  
Development  
Cooperation**





# ANALIZA E SEKTORIT TË PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE



Ky studim është shkruar si pjesë e partneritetit me Shoqatën PePeKo në projektin “Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës” (SIREd), i zbatuar nga Caritas-i Zviceran dhe i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), njësi operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e Shoqatës PePeKo dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA, ose të Caritas-it Zviceran.



# PËRMBAJTJA

<i>Lista e Akronimeve</i> .....	6
<i>Lista e Figurave</i> .....	7
<i>Lista e Tabelave</i> .....	7
<b>Përmbledhja e përgjithshme</b> .....	8
<b>Shoqata e Përpunuesëve të Pemëve dhe Perimeve – PePeKo</b> .....	9
<b>1. Hyrja</b> .....	10
<i>1.1 Zhvillimi i sektorit të pemëve dhe perieve</i> .....	10
<b>Metodologjia</b> .....	11
<i>2.1 Dizajni i përgjithshëm i studimit</i> .....	11
<b>3. Zhvillimi i sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve</b> .....	12
<b>4. Rezultatet dhe Diskutime</b> .....	17
<i>4.1 Fuqia punëtore në sektor</i> .....	17
<i>4.2 Implementimi i standarteve të sigurisë së ushqimit</i> .....	19
<i>4.3 Kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të kompanive të përpunimit të pemëve dhe perimeve</i> .....	20
<i>4.3 Furnizimi me lëndë të parë</i> .....	21
<i>4.4 Shitjet vendore dhe eksporti</i> .....	22
<i>4.5 Investimet dhe investimet e planifikuara në sektor</i> .....	24
<b>5. Konkurrenca në sektor dhe aktivitetet promovuese</b> .....	25
<i>5.1 Konkurrenca lojale kundrejtë asaj ndërkombëtare</i> .....	25
<i>5.2 Pengesat kryesore në sektor</i> .....	26
<b>6. Konkluzionet</b> .....	28
<b>7. Rekomandimet</b> .....	30
<b>Literatura</b> .....	32

## LISTA E AKRONIMEVE

**ADA** – Austrian Development Agency

**AKK** – Agjencia Kosovare e Konkurrencës

**ASK** – Agjencia e Statistikave të Kosovës

**BE** – Bashkimi European

**GIZ** - The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

**MBPZHR** – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**MINT** – Ministria e Industrisë, Ndërmarrjes dhe Tregtisë

**PEPEKO** – Shoqata e Përpunimit të Pemëve dhe Perimeve të Kosovës

**PPSE** – Promoting Private Sector Employment

**SIREd** – Sustainable and Inclusive Rural Economic Development

**USAID** – U.S. Agency for International Development

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Struktura e sipërfaqes së kultivuar me perime .....	11
Figura 2: Struktura e sipërfaqes së kultivuar me pemë.....	11
Figura 3: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve .....	12
Figura 4: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve.....	13
Figura 5: Implementimi i standarteve të SSU.....	16
Figura 6: Kapacitet e kompanive vendore .....	17
Figura 7: Furnizimi me lëndë të parë.....	18
Figura 8: Furnizimi me lëndë të parë vendore .....	19
Figura 9: Shitjet totale të kompanive vendore .....	20
Figura 10: Natyra e konkurrencës.....	22
Figura 11: Format e konkurrencës .....	22

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Totali i tokës së punueshme të përdorur 2020 .....	10
Tabela 2: Sipërfaqja e kultivuar me perime dhe pemë .....	11
Tabela 3: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve .....	12
Tabela 4: Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve .....	12
Tabela 5: Sipërfaqja dhe prodhimi i Pemëve dhe Perimeve në Kosovë .....	13
Tabela 6: Numri i punëtorëve në kompanitë e intervistuar.....	14
Tabela 7: Implementimi i standarteve të sigurisë së ushqimit.....	16
Tabela 8: Kapacitetet e kompanive të përpunimit .....	17
Tabela 9: Kulturat kryesore të pemëve dhe perimeve të grumbulluara në vitin 2021.....	18
Tabela 10: Shitjet vendore dhe eksporti '19, '20, '21 .....	20
Tabela 11: Investimet e kompanive vendore për vitin 2021 dhe investimet e planifikuara .....	21



# PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

Qëllimi kryesor i hulumtimit është mbledhja dhe shpërndarja e informacioneve mbi zhvillimin e sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve për vitin 2021. Ky raport ka për qëllim të informojë kompanitë vendore dhe akterët e tjerë të sektorit të pemëve dhe perimeve për mundësitë apo kërcënimet e mundshme në lidhje me përpunimin dhe prodhimin e pemëve dhe perimeve në Kosovë. Për më tepër, vlerësimi i gjendjes së sektorit ka për qëllim të informojë ekspertët vendorë, institucionet vendore dhe palët tjera me interes në bujqësi dhe agrobiznes për mundësitë specifike të industrisë përpunuese të ushqimit për rritjen e potencialit përpunues, krijiminin e vendeve të reja të punës si dhe përmirësimin e tërë zingjirit të vlerës së përpunimit të pemëve dhe perimeve. Temat kyçe të trajtuara në studim janë:

- \* Zhvillimi i sektorit për vitin 2021;
- \* Kapacitet e instaluara dhe shfrytëzuara në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë;
- \* Gjendja e tregut dhe eksportit për produktet e përpunuara;
- \* Analizat e punësimit dhe potenciali për krijimin e vendeve të punës;
- \* Analiza e mjedisit të biznesit për sektorin.

Të dhënat në raport janë të dhëna kualitative dhe kuantitative të cilat e mbulojnë këtë sektor dhe që e japin informacione për sfidat dhe mundësitë e kompanive vendore drejt zhvillimit të qëndrueshmën ekonomik dhe social të tyre. Metodologjia e përdorur në këtë raport përfshin punë dhe analizë zyrtare nga të dhënat primare dhe sekondare në dispozicion:

- \* Të dhënat primare, që u mblodhën përmes realizimit të pyetësorit tek 22 kompani të përpunimit të pemëve dhe perimeve në dy rajonet e Kosovës.
- \* Të dhënat sekondare dhe terciare, ku si burime të informacioneve janë përdorur faqet zyrtare, raportet zyrtare nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, libra dhe publikime shkencore të kësaj fushe.



# SHOQATA E PËRPUNUESËVE TË PEMËVE DHE PERIMEVE – PEPEKO

Shoqata e përpunuesëve të pemëve dhe perimeve PePeKo, është një shoqatë jofitimprurëse e themeluar në vitin 2014. Objektivi kryesor i shoqatës është mbrojtja e interesave të përpunuesve vendorë, në mënyrë që të zhvillojë më tej industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve, për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe punësim, përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës në sektorin e pemëve dhe perimeve në Kosovë. Shoqata PePeKo është një përfaqësuese e sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë, ku aktualisht përfaqëson 25 kompani të përpunimit të pemëve dhe perimeve në vend të cilat furnizohen kryesisht nga prodhuesit vendorë të pemëve dhe perimeve. Objektivat kryesore të shoqatës janë:

- \* Të mbrojtë interesat e industrisë së përpunimit të pemëve dhe perimeve;
- \* Të rris kapacitetet përpunuese të kompanive vendore dhe të përmirësojë cilësinë e produkteve të përpunuara vendore;
- \* Të mbështesë anëtarët e shoqatës për të gjetur tregje të reja eksporti;
- \* Të marrë pjesë në grupe pune të organizuara nga institucionet lokale në lidhje me legjislacionin dhe çështje të tjera për industrinë e përpunimit të ushqimit.

Gjithashtu, shoqata organizon aktivitetet e më poshtme si:

- \* Takime koordinuese me palët kryesore të interesit nga sektori;
- \* Aplikim i përbashkët për të mbështetur dhe organizuar zinxhirin e vlerës në industrinë e përpunimit të ushqimit;
- \* Organizimi i vizitave në vendet e rajonit dhe BE-së për të gjetur tregje të reja;
- \* Organizimi i pjesëmarrjes në panairë ndërkombëtare që lidhen me industrinë e përpunimit të ushqimit;
- \* Trajnime dhe punëtori me qëllim të ngritjes së kapaciteteve humane në sektor;
- \* Aktivitete të tjera me qëllim të mbrojtjes së prodhuesve vendorë nga konkurrenca e pandershme.

Bazuar në aktivitetet e organizuara nga Shoqata PePeKo, si dhe prezantimi i duhur i sektorit të përpunimit të pemëve dhe perimeve, gjatë dy viteve të fundit, interesimi i kompanive të përpunimit për të qenë anëtarë të PePeKo-së është rritur. Tani ekzistojnë 20 kompani përpunuese që vazhdimisht marrin pjesë në aktivitetet e shoqatës. Kjo iniciativë do të sigurojë që Shoqata Kosovare e përpunimit të pemëve dhe perimeve të jetë plotësisht operacionale dhe e forcuar, në mënyrë që të ofrojë shërbime për anëtarët e saj.

Shoqata ka treguar potencialet e saj dhe nevojën për subjekte të tilla në këtë sektor. Sidoqoftë, përvoja e kaluar dhe mos ekzistenca e një forme të tillë përfaqësimi ka penguar zhvillimin e grupeve të tilla. Kompanitë lokale kanë identifikuar nevojën dhe rëndësinë që të organizohen si një grup interesi për të qenë më përfaqësues dhe më të fuqishëm. Shoqata e përpunuesve të pemëve dhe perimeve është një faktor shumë i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës që përfaqëson një urëlidhëse për më shumë se 10,000 prodhues të pemëve dhe perimeve dhe konsumatorëve në tregun vendor dhe ndërkombëtar. Duke zbatuar aktivitetet e tilla dhe duke qenë përfaqësuese e sektorit, Shoqata do të forcohet dhe do të jetë në gjendje të vazhdojë kontributin e saj në zhvillimin e sektorit të pemëve dhe perimeve në Kosovë.

# 1. HYRJA

## 1.1 ZHVILLIMI I SEKTORIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

Bujqësia luan rol dhe funksion shumë të rëndësishëm ekonomik, social dhe kulturor për familjet rurale pasi ajo kontribuon në përmirësimin e të ardhurave dhe mirëqenies së tyre. Ajo ndihmon në furnizimin me ushqim, rritjen e të ardhurave, në ruajtjen dhe përmirësimin e produktiviteti të tokës, diversifikimin bujqësor, prodhimin e qëndrueshëm bujqësor, punësimin e familjes dhe komunitetit (Sawant, et al., 2005). Marrë parasysh mbulueshmërinë e madhe me tokë bujqësore, bujqësia e Kosovës përbën një nga vepërimitaritet kryesore ekonomike të vendit. Në vitin 2016 gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 415,826 ha, kurse në vitin 2017 vërehet një rritje e lehtë, duke vazhduar me rritje edhe në vitin 2018 ku sipërfaqe ishte 418,582 ha.

Rritja e shfrytëzimit të tokës bujqësore vazhdoi edhe në vitin 2019 dhe në këtë rast sipërfaqja arriti në 420,141 ha, që tregon një ndryshim në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 për 0.4 %. Sipërfaqe më të madhe të tokës së shfrytëzuar zënë livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët) që përbën 51.9 % të gjithësej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore. Kjo kategori e tokës për këtë periudhë kohore vërehet se nuk ka pasur ndryshime të theksuara. Në vitin 2019 kjo sipërfaqe ishte 217,931 ha, që paraqet një rënie në krahasim me vitin 2018 për 0.1 %. Pas livadheve dhe kullosave sipërfaqe më të madhe si edhe në vitet tjera edhe në vitin 2019 ka kategoria e tokës së punueshme-ara, me pjesëmarrje prej 44.8 %, që paraqet sipërfaqen prej 188,365 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (kulturë e parë) dhe e serrave (kulturë e parë) (MAFRD, 2020).

Në kuadër të sipërfaqes së tokës së punueshme-arave hyjnë edhe perimet në fushë të hapur si kulturë e parë (8,319 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (517 ha). Në vitin 2019 sipërfaqja e perimeve ka shënuar rritje në krahasim me vitet tjera, kështu që në krahasim me vitin 2018 kjo sipërfaqe është rritur për 6.4%. Edhe tek sipërfaqja me serra ka pasur rritje të sipërfaqes në krahasim me vitet tjera. Të dhënat tregojnë se në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018 paraqitet shtimi i sipërfaqes së kultivuar me perime në serrë si kulturë e parë për 10.6%.

Sipërfaqe më e vogël me kopshte paraqitet në vitin 2016 me 994 ha, duke vijuar me rritje në vitet në vijim. Në vitin 2019 kjo sipërfaqe ishte 1,122 ha, që është një ndryshim në rritje prej 11.9% për dallim nga viti 2018. Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në vitin 2016 ishte 5,493 ha, me rritje në vazhdimësi deri në vitin 2019, kur kjo sipërfaqe arriti në 9,244 ha. Në vitin 2019 kemi rritje prej 20.3% në krahasim me vitin 2018. Sa i përket sipërfaqes së vreshtave nuk kemi ndryshime të theksuara në periudhën 2016-2019. Rritje në sipërfaqe të vreshtave paraqitet në vitin 2019 që tregon një rritje në krahasim me vitin 2018 për 2.9% (MAFRD, 2020).

Sipas të dhënave të raportuara në Raportin e Gjellbër të vitit 2020 (të dhënat që paraqesin zhvillimin për vitin 2019), PBB-ja e Kosovës është 7.1 miliardë Euro, dhe bujqësia merr pjesë me 7.6 % ose 545.2 milion Euro. Për më tepër, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rritja reale e bujqësisë ishte 8 %. Në vitin 2019, rreth 92,769 ton të pemëve dhe perimeve të freskëta janë importuar me një vlerë mbi 38 milion Euro. Importi i pemëve zë rreth 39 %, ndërsa vlera e pemëve të importuar është rreth 13 milion € nga sasia totale e importuar.

Importet e perimeve të freskëta marrin pjesë me 61 % të sasisë totale të importuar ose rreth 25 milion euro nga shuma totale e deklaruar (ASK, 2021).

## 2. METODOLOGJIA

### 2.1 DIZAJNI I PËRGJITHSHËM I STUDIMIT

Qasja e studimit ishte qasje induktive-kërkimore dhe është realizuar në katër faza: 1) fillimi i vëzhgimit dhe matjeve, 2) zgjedhjen e modeleve hulumtuese, 3) formulimi i objektivave, dhe në fund 4) analizimin e të dhënave dhe interpretimin e rezultateve (Zhitia, 2017). Studimi u krye në 20 kompani të përpunimit të pemëve dhe perimeve në dy rajonet e Kosovës gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2021.

Metodologjia e përdorur për këtë hulumtim bazohet në dy qasje kryesore të përdorura në studimet e mëparshme në sektorin e pemëve dhe perimeve të përpunuara: intervistat me kompanitë dhe hulumtimet në tryezë (dytësore). Të dhënat e hulumtimit në tryezë janë përdorur nga burime të besueshme të institucioneve publike, të tilla si MBPZHR, ASK, etj.

Këto të dhëna u përdorën si sfond konteksti për sektorin. Të dhënat nga intervistat janë mbledhur nga takimet fizike me pronarët ose menaxherët e nivelit të lartë. Pyetësi u krijua për të mbuluar objektivat e projektit dhe informacioni shtesë i mbledhur nga kompanitë ka shërbyer si bazë për të përpunuar më tej rezultatet e studimit. Gjatë intervistave kemi mbledhur informacione në lidhje me punësimin, shitjet, eksportin, si dhe të dhëna mbi mbledhjen e pemëve dhe perimeve, investimet, aktivitetet promovuese dhe vështirësitë dhe sfidat e kompanive vendore.

Rezultatet e studimit rrjedhin kryesisht nga përgjigjet e kompanive të intervistuar dhe të dhëna dytësore janë përdorur kryesisht për qëllime krahasuese. Shkalla e pjesëmarrjes së kompanive të zgjedhura në hulumtim ishte rreth 95 %, duke treguar kështu një gatishmëri të lartë të bashkëpunimit midis akterëve të sektorit.

### 3. ZHVILLIMI I SEKTORIT TË PËR- PUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

Sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, industria e përpunimit të pemëve dhe perimeve në vitet e fundit ka pasur një konsolidim përsa i përket investimeve në asete fizike dhe makineri, por zhvillimi i saj i përgjithshëm ka qenë i ngadaltë. Vështirësitë e këtij sektori janë kryesisht rezultat i ndikimit të faktorëve të ndryshëm si organizimi i zinxhirit të furnizimit, organizimi i shitjes së produkteve, politikat fiskale dhe politikat bujqësore të cilat jo gjithmonë kanë favorizuar prodhuesit vendorë. Përveç këtyre vështirësive të përmendura më sipër, shumë kompani kanë vështirësi në furnizimin e qëndrueshëm të lëndëve të para si rezultat i strukturës së fermave në vendin tonë.

Shumica e fermave bujqësore kanë tokë të punueshme prej 2.5 hektarësh e cila së paku ndahet në 5 parcela, gjë që e pamundëson zhvillimin e bujqësisë intensive. Bazuar në të dhënat e Raportit të Gjellbër të MBPZHR të vitit 2020, numri i të punësuarëve në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve është rreth 10,000 punëtorë me ndryshime të lehta gjatë viteve. Vetëm në vitin 2019 në këtë sektor ishin të punësuar rreth 12,467 punëtorë të cilët janë të përfshirë drejtpërdrejt në këtë industri. Nën-sektori i pemëve dhe perimeve në Kosovë përbën rreth 4.5% të të gjithë sektorit të bujqësisë për sa i përket përdorimit të tokës. Kjo përfshin pemë frutore, perime, kopshte, vreshta dhe fidanë.

Në vitin 2016, sipërfaqja totale e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 415,826 ha, ndërsa në 2017 kishte një rritje të lehtë, duke vazhduar të rritet në 2018 ku sipërfaqja ishte 418,582 ha. Rritja e përdorimit të tokës bujqësore vazhdoi edhe në vitin 2019 dhe në këtë rast sipërfaqja arriti në 420,141 ha. Bazuar në Raportin e Gjellbër (2020) struktura e përdorimit të tokës së punueshme në Kosovë përshkruhet në tabelën e më poshtë dhe tregon se pothuajse gjysma e tokës së punueshme përdoret për bujqësi të gjerë përfshirë livadhet dhe kullosat, dhe pjesa tjetër është e ndarë për sektorët tjetër të bujqësisë duke përfshirë prodhimin e perimeve, pemëve frutore, vreshtave, etj.

**TAB. 1 Totali i tokës së punueshme të përdorur 2020**

Përdorimi total i tokës së punueshme	Sipërfaqja në ha
Toka e punueshme	188,366
Perimet në fushë të hapur	8,319
Perimet në serra	518
Kopsht	1,122
Vreshtat	3,367
Fidanët	111
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	217,932
<b>Toka e përgjithshme bujqësore e përdorur</b>	<b>420,142</b>

Bazuar në informacionin e paraqitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në raportin e Anketave të Ekonomisë Bujqësore për vitin 2019, perimet dhe pemët kryesore të kultivuara janë paraqitur në tabelën më poshtë:


**TAB. 2 Sipërfaqja e kultivuar me perime dhe pemë**

Zonë e kultivuar me perime dhe pemë kryesore*Ha	
Speca 3,108.15	Mollë 3,006.37
Domate 794.18	Kumbullë 2,096.25
Tranguj 303.76	Mjedër 1,636.82
Lakër 905.85	Pjeshkë 609.86
Qepë 1,354.03	Qershë 232.35
<b>Sipërfaqja e përgjithshme 6,465.97</b>	<b>Sipërfaqja e përgjithshme 7,581.65</b>

Burimi: ASK, Rezultatet e Anketës së Pronave Bujqësore, 2019


**Struktura e sipërfaqes së kultivuar me perime**

**FIG. 1** Struktura e sipërfaqes së kultivuar me perime



## Struktura e sipërfaqes së kultivuar me pemë

**FIG. 2** Struktura e sipërfaqes së kultivuar me pemë



Sipas të dhënave të mbledhura nga Departamenti për Analiza Ekonomike në Ministrinë e Bujqësisë përmes Anketave Bujqësore në vitin 2019 rendimenti mesatar për hektar në kulturat kryesore të pemëve është 6.40 tonë për hektar, ndërsa për perimet kryesore rendimenti mesatar është 24.03 tonë për hektar. Këto të dhëna janë prezantuar në tabelën vijuese:


## Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve\*Ha

**TAB. 3** Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve

Kultura / Vit	2015	2016	2017	2018	2019
Specë	3,090	3,363	3,035	3,038	3,108
Domate	791	866	862	757	794
Tranguj	317	259	305	273	304
Lakër	594	807	917	832	906
Qepë	1,079	1,228	1,465	1,185	1,354

### Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve

**FIG. 3** Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të perimeve




Sidoqoftë, nëse analizojmë zonën e mbjellur me pemë (shkurre frutore), mund të shohim se pemishtet e mollëve, kumbullave dhe mjedrave kanë sipërfaqet më të mëdha dhe kjo për shkak të rritjes nga viti në vit. Në tabelën 4 të paraqitur më poshtë, mund të vërehet rritja vjetore e sipërfaqes së kultivuar.

### Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve\*Ha

**TAB. 4** Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve

Kultura / Vit	2015	2016	2017	2018	2019
Mollë	1,972	2,076	2,155	2,556	3,006
Kumbullë	1,518	1,518	1,524	1,821	2,096
Mjedër	324	797	1,231	1,537	1,637
Dardhë	367	416	456	479	610
Vishnje	147	148	149	167	232

### Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve



### Sipërfaqja e kultivuar me kulturat kryesore të pemëve\*Ha

**TAB. 5** Sipërfaqja dhe prodhimi i Pemëve dhe Perimeve në Kosovë

Prodhimi/vit	2015	2016	2017	2018	2019
Sipërfaqja me pemë (Ha)	4,930	5,668	6,422	7,922	9,479
Prodhimi i pemëve (Ton)	44,674	54,836	34,207	53,606	7,294
Sipërfaqja me perimeve (Ha)	14,656	17,395	19,643	17,886	18,911
Prodhimi i perimeve (Ton)	246,096	335,467	358,394	265,420	300,559

Burimi: ASK – Anketa e Ekonomive Bujqësore ('15, '16, '17, '18, and '19);



# 4. REZULTATET DHE DISKUTIME

## 4.1 FUQIA PUNËTORE NË SEKTOR

Zhvillimi i zonave rurale në Kosovë tregon se bujqësia është e dominuar nga ferma me sipërfaqe të vogël (mesatarisht 1.5 hektarë) dhe të copëzuara në mesatarisht 5 parcela/fermë, gjë që përbën një pengesë të rëndësishme për rritjen e produktivitetit të tokës dhe zhvillimin eficient të sektorit bujqësor. Rritja e sektorit bujqësor është nën mesataren kombëtare dhe, njëherësh, larg potencialeve reale. Kjo vjen si rezultat i problemeve me të cilat përballet sektori, ku mbizotërojnë ato të lidhura me eksodin rural, sipërfaqen e kufizuar të fermave dhe pronësinë mbi token, marketingun e produkteve, ujitjen dhe kullimin, nivelin e ulët të teknologjive të përdorura, organizimin e dobët të fermerëve, nivelin e ulët të zhvillimit të industrisë agroushqimore dhe peshës e ulët që ka bujqësia në këtë hallke të sistemit etj., duke zbehur në këtë mënyrë interesin për investime serioze në fushën e agrobiznesit, në dobi të nxitjes së punësimit dhe rritjes së nivelit të prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe përpunimin e tyre të mëtejshëm (Hodaj, 2016).

Roli i bujqësisë në zhvillimin rural konsiderohet aktivitet i tejet i rëndësishëm ekonomik i cili krijon mundësi për punësime lokale dhe që krijon përfitime të shumëfishta ekonomike, sociale dhe territoriale sipas të dhënave nga Anketa e Riinvestit me familje dhe Tregun e Punës, numri i të punësuarve në Kosovë llogaritet të jetë rreth 430,000. Një numër i konsiderueshëm i tyre është i punësuar në sektorin privat (45% e punësimit përgjithshëm) dhe në bujqësi (22%).

Nëse llogarisim këtu numrin e punëtorëve sezonal atëherë numri i të punësuarve në bujqësi rritet në 160,000 njerëz (Riinvest, 2018). Punësimi është një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet bujqësia viteve të fundit, kjo sfidë gjithashtu ka prekur edhe industrinë e përpunimit. Shumica e ndërmarrjeve përpunuese kanë problem të vazhdueshëm të punësimit të punëtorëve në profileve të ndryshme profesionale, të cilat do të përmenden më poshtë në raport.

Sipas informacionit të mbledhur lidhur me punësimin në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve, kompanitë vendore në vitin 2021 kishin të punësuar 2,043 të punësuar, prej të cilëve 1,211 apo afro 58.3 % ishin të punësuar me kohë të plotë dhe 852 apo 41.7 % të punësuar sezonal, 65 % e të punësuarëve janë të grup moshës 20 - 45 vjeçare.

### Numri i punëtorëve në kompanitë e intervistuar

**TAB. 6** Numri i punëtorëve në kompanitë e intervistuar

Viti	2020	2021	Diferenca në %
Numri total i të punësuarëve	2,029	2,043	0.70
Punëtorët me kohë të plotë	1,157	1,211	4.67
Punëtorët sezonal	872	852	2.29
Gra të punësuar	856	640	25.23
Minoritete	262	250	4.58
Të kthyerit	2	3	0.5

Duke krahasuar rezultatet e vitit 2021 me vitin 2020 shohim se ka ngritje të lehtë të të punësuarëve me kohë të plotë për rreth 0.7 % dhe rënjie prej 2.29 % të numrit të punëtorëve sezonal.

Fuqia e shkathët punëtore që është e aftë t'i përgjigjet nevojave të tregut është ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në konkurrueshmërinë e kompanive Kosova në vazhdimësi është promovuar si një destinacion i përshtatshëm për investime për shkak të kostove më të ulëta të fuqisë punëtore, duke iu mundësuar kompanive të reduktojnë kostot operacionale dhe të jenë më konkurrues në treg. Megjithatë, gjatë viteve të fundit në Kosovë, rëndësi më e madhe i jepet pjesës së një fuqie të kualifikuar punëtore që është në gjendje t'i përshtatet nevojave të kompanive (Oda Ekonomike Amerikane, 2018).

Duke u bazuar në përgjegjet e marra nga kompanitë e intervistuar, mungesa e kuadrove të përgatitura për profileve e caktuara, ka ndikuar në mungesën e zhvillimit të produkteve, rritjen e efikasitetit të makinerisë dhe punëtorëve, vështirësi në depërtimin e tregjeve të reja dhe rritjen e konkurrueshmërisë në sektor. Kur janë pyetur kompanitë, nëse kanë hasur në vështirësi në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar, 17 kompanitë kanë deklaruar se janë ballafaquar me mungesë të punëtorëve të kualifikuar dhe në disa raste kur punëtorët kanë qenë të kualifikuar dhe me përvojë, ata nuk kanë shprehur gatishmëri për të punuar për pagën e ofruar në tregun e punës në Kosovë. Profilet deficit për kuadrot e caktuar janë:

- **Teknolog/e i/e ushqimit me përvojë;**
- **Teknik/e laborator i industrisë ushqimore;**
- **Teknik/e i/e prodhimit;**
- **Agronom/e;**
- **Mirëmbajtësi/e i/e pajisjeve të prodhimit;**
- **Inxhinier/e elektrik për pajisje industriale;**
- **Inxhinier/e mekanik për pajisje industriale;**
- **Agjentë/e i/e shitjes me përvojë;**
- **Enolog/e.**

Sa i përket nivelit të arsimimit të punëtorëve, 17 kompani kanë deklaruar që janë mjaftueshëm të kënaqur me nivelin e arsimimit të punëtorëve për punët që ata bëjnë, 2 kompani janë të pakënaqura me nivelin e arsimimit të punëtorëve dhe 3 prej tyre kanë deklaruar se të punësuarit kanë nivel të kënaqshëm të arsimimit.

Ngritja e kapaciteteve humane në kompani akoma nuk është objektivi kryesor i kompanive vendore. Në pyetjen se sa investojnë në edukimin dhe organizimin e trajnimeve, shumica nga ta kanë deklaruar që i organizojnë në bazë të nevojës. Trajnimet dhe përmirësimet bazohen në nevojën e kompanive për të rritur arsimimin e stafit drejtues dhe punëtorëve tjerë, duke ndjekur trajnime të ndryshme në lidhje me implementimin e standarteve të sigurisë së ushqimit, qasja në financa, organizimi i menaxhimit, etj.

## 4.2 IMPLEMENTIMI I STANDARTEVE TË SIGURISË SË USHQIMIT


Në kohën e tregjeve globale dhe marrëdhënieve gjithnjë e më komplekse konsumator-furnizues, standardet e sigurisë ushqimore ndihmojnë për të përmbushur sfidat ekzistuese në shkallën më të mirë të mundshme. Standardet e sigurisë ushqimore kontribuojnë në krijimin e besueshmërisë së konsumatorëve mbi sigurinë dhe cilësinë ushqimore të produkteve të caktuara. Kompanitë e përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë kanë mbetur mbrapa sa i përketë certifikimeve të sigurisë ushqimore.

### Implementimi i standarteve të sigurisë së ushqimit

**TAB. 7** Implementimi i standarteve të sigurisë së ushqimit

Certifikimi për Standarde të Sigurisë Ushqimore	Numri i kompanive të certifikuara
HACCP	6
ISO 22000	5
ISO 9001	2
HALLALL	1
Organik	2
HACCP në proces të implementimit	2
ISO në proces të implementimit	2
Nuk kanë certifikim për SSU	7

### Numri i kompanive të certifikuara




### 4.3 Kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të kompanive të përpunimit të pemëve dhe perimeve

Kompanitë vendore në vitet e fundit janë përkushtuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese, rritjen e gamës së produkteve dhe cilësisë së tyre. Në këtë mënyrë po ngritet konkurrueshmëria e kompanive vendore dhe po përmirësohet performanca ekonomike e tyre. Nga mostra e studimit, është gjetur që kapacitetet totale të instaluar janë rreth 41,770 t, objektet me temperaturë dhomë përfshijnë një hapësirë prej 26,958 m<sup>2</sup>, dhe objektet në temperaturë (- °C) rreth 20,535 m<sup>2</sup>. Edhe pse trendi i rritjes së kapaciteteve po vazhdon, shqetësues mbetet fakti i shfrytëzimit të kapaciteteve të instaluar. Nga intervistat e realizuara në kompanitë vendore, gjetjet tregojnë që shfrytëzimi i kapaciteteve të instaluar nuk kalon vlerën 59 % (mean: 58.73 %; CI luhatet mes 25 % deri në 95 %).

**TAB. 8 Kapacitetet e kompanive të përpunimit**

	Kapacitetet ekzistuese	Kapacitete e shfrytëzuara
Kapaciteti i Kompanive * Ton	45,770	26,547
Objekte (Temp. Dhome) * m2	34,958	20,275
Dhoma ftohëse (-°C) * m2	20,735	12,026

**FIG. 6 Kapacitet e kompanive vendore**



## 4.3 Furnizimi me lëndë të parë

Lënda e parë, e lidhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë me gjendjen dhe menaxhimin e furnizimit, ndikon së tepërmi në produktet e përpunuara. Madhësia dhe gjendja e zhvillimit të fermave shqiptare paraqet një sfidë për shumicën e agro-përpunuesve që punojnë me burime vendase. Kjo e bën menaxhimin e zinxhirit të furnizimit një funksion kyç për agro-përpunimin i cili ndikon drejtëpërdrejt në cilësinë, sasinë dhe larinë e lëndëve të para (Ilijazi, et al., 2017).

Prodhimi bujqësorë është në esencë një biznes i rrezikshëm dhe fermerët përballen me një larmi të madhe të faktorëve ndikues si moti, dëmtuesit, sëmundjet, furnizimi i inputeve dhe rreziqet që lidhen me tregun. Prandaj, krijimi dhe organizimi i një zingjiri stabil të furnizimit me lëndë të parë mbetet sfidë për përpunuesit vendorë. Bazuar në politikat shtetërore të bujqësisë, por edhe falë donatorëve, ka një tendencë në zhvillim për kultivimin e të gjitha llojeve të pemëve dhe perimeve e për të përmbushur kërkesat e brendshme të tregut me produkte të freskëta si dhe mbulimin e furnizimit për kompanitë e përpunimit.


Nga të dhënat e mbledhura, besohet se në mënyrë direkt dhe indirekt janë përfshirë më shumë se 5,000 fermerë në të gjithë territorin e Kosovës në këtë sektor. Sasia e perimeve të mbledhura nga kompanitë përpunuese në vend për vitin 2021 ishte rreth 15,900 ton, ndërsa sasia e pemëve ishte 7,500 ton. Kulturat kryesore të grumbulluara të perimeve për vitin 2021 janë speca me rreth 4,719 t, domate me 1,149 t, dhe lakër me 698.5 t. Perime tjera janë, tranguj, karrota, presh, lule lakër etj. Kultura kryesore të pemëve të grumbulluara për vitin 2021 janë mollë me rreth 4,400 t, vishnje rreth 1,500 t, kumbullë 630 t, pemë tjera janë pemë të imta, dardhë, pjeshkë, etj. Këto të dhëna janë prezentuar në tabelën vijuese:

**TAB. 9 Kulturat kryesore të pemëve dhe perimeve të grumbulluara në vitin 2021**


Perime Sasia*t	Pemë Sasia*t
Speca 4,719	Mollë 4,400
Domate 1,149	Vishnje 1,500
Lakër 698.5	Kumbullë 630
Tranguj 467	Pemë të imta 579
Karrota 293.5	Dardhë 50

Sipas, intervistuesëve, furnizimi me lëndë të parë nga fermerët vendorë është rreth 93 % ( $\pm 2.3$  %) dhe vetëm 7 % vjen nga pemët dhe perimet e importuara.

**FIG.7 Furnizimi me lëndë të parë**



**FIG. 8 Furnizimi me lëndë të parë vendore**



Kompanitë e përpunimit, në varësi të llojit të kulturave bujqësore që mbledhin për përpunim, përdorin dy kanale kryesore furnizuese: direkt nga fermerët dhe indirekt, nga qendrat e grumbullimit të pemëve dhe perimeve.

Duke marrë parasysh që furnizimi i shumicës së kompanive realizohet nga pikat e grumbullimit dhe drejtpërdrejt nga fermerët, është e nevojshme të vendosen marrëdhënie kontraktuale në mënyrë që të kemi një garanci që fermerët do t'i dorëzojnë produktet e tyre tek kompanitë përpunuese. Sipas të dhënave nga terreni, kompanitë bashkëpunojnë me 16 qendra grumbulluese të pemëve dhe perimeve, 1,701 fermerë prej të cilëve me 1,097 fermerë kanë marrëveshje kontraktuale dhe me 604 fermerë ku bashkëpunimi është i paformalizuar akoma. Sa i përket bashkëpunimit me blerës, kompanitë vendore kanë deklaruar që kanë 415 kontrata tregtare me supermarketet, 331 kontrata me tregtarë me shumicë, 453 kontrata me tregtarë me pakicë, dhe 34 kontrata me shpërndarës.


## 4.4 Shitjet vendore dhe eksporti

Kosova ka një regjim liberal të tregtisë, i cili karakterizohet me thjeshtësi dhe neutralitet, tipare kryesore që konsiderohen të jenë të rëndësishme për stimulimin e rritjes së sektorit privat, si dhe për krijimin e kushteve për eksport të mirë (Riinvest, 2003). Eksportet dhe importet kontribuojnë fuqishëm në Bruto Produktin Vendor (BPV) të shumicës së vendeve. Me vazhdimin e liberalizimit të tregtisë globale, secilën herë e më shumë, edhe ndërmarrjet kosovare po i bashkangjiten tregut ndërkombëtar (Karl, 2014). Me rritjen e investimeve në ngritjen e kapaciteteve prodhuese, rritjen e gamës së produkteve dhe implementimin e standarteve të sigurisë së ushqimit kompanitë vendore kanë rritur konkurrueshmërinë e produkteve të tyre, duke përmirësuar edhe performancën e tyre ekonomike.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga intervistat e drejtpërdrejta, gjatë vitit 2021 kompanitë vendore kanë realizuar shitje rreth 35 milion euro, prej të cilave rreth 24.3 milion në tregun e brendshëm dhe 10.7 milion euro eksport.

**TAB. 10 Shitjet vendore dhe eksporti '19, '20, '21**

Viti	2019	2020	2021	Diferenca mes vitit 2021 - 2019	Diferenca mes vitit 2021 - 2020
Shitjet totale * €	31,054,000	32,648,000	34,988,000	11.24 %	6.70 %
Shitjet vendore * €	21,380,000	21,144,000	24,335,000	12.14 %	13.11 %
Shitjet eksportuese * €	6,524,000	7,653,000	10,653,000	38.76 %	28.16 %

**FIG. 9 Shitjet totale të kompanive vendore**

Nëse krahasojmë vitin 2021 me vitin 2019 dhe 2020, vërejmë që kemi rritje të shitjeve totale (shitjeve në vend dhe eksport). Në krahasim me vitin 2019 diferenca është rreth 11.24 %, ndërsa në krahasim me vitin 2020 diferenca është rreth 6.7 %. Vendet kryesore të eksportit janë: Gjermania, Zvicra, Italia, Austria, Finlanda, Suedia Belgjika, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kuvajti, si dhe ShBA-t.

Kompanitë e intervistuar kryesisht produktet e tyre si shesin si produkte finale, por ka edhe nga ato që shesin produkte si gjysm produkte dhe si lëndë të para. Nga përgjegjjet e marra, rezultojnë që 18 kompani shesin produktet e tyre si produkte finale, 3 të kombinuara si produkte finale dhe gjysëm të përpunura dhe vetëm një kompani shet produktet si lëndë të para. Produktet kryesore të shitura për vitin 2021 janë: ajvari, turshitë, mermelatë dhe xhemat, keçap, sos si dhe supat e ndryshme.

Strategjia e orientuar kah rritja e shitjeve në tregun e brendshëm dhe rritja e eksportit duhet të konsiderohet si një faktor kyç në ndërtimin e ekonomisë së hapur dhe të lirë të tregut dhe në reduktimin e debalancave të mëdha në Kosovë. Prandaj, fokusi i institucioneve dhe donatorëve duhet të jetë promovimi i produkteve vendore dhe nxitja e eksportit në vendet e rajonit dhe Europës.

## 4.5 Investimet dhe investimet e planifikuara në sektor

Ekonomia bujqësore dhe veprimtaritë që lidhen me këtë aktivitet konsiderohen motor ekonomik i vendit tonë, duke luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social. Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve, çdo ditë e më shumë po fuqizohet, përmes inovacionit në makineri, ndërtimin e qendrave përpunuese, zhvillimin e kapitalit human dhe prodhimin e produkteve të sigurta e cilësore, duke u bërë kështu vlerë për ekonominë dhe tregtinë e Kosovës.

Në studimin tonë, kemi qenë të interesuar të vlerësojmë edhe investimet e bëra në sektor, planet e kompanive për investim në të ardhmen dhe ndikimin e granteve në rritjen e konkurrueshmërisë. Vlera totale e investimeve të bëra në sektor kap shumën rreth 23 milion euro. Vetëm gjatë vitit 2021, kjo vlerë është rreth 7.4 milion euro. Nga shuma totale e investimeve rreth 65.8 % ka qenë në makineri, 16.8 % në objekte dhe qendra përpunuese, 2.75 % në hapësira ftohëse dhe vetëm 1 % në kualifikim dhe përgatitje të stafit të kompanive.

**TAB. 11 Investimet e kompanive vendore për vitin 2021 dhe investimet e planifikuara**

Investimet* €	Investimet 2021	Investimet e planifikuar 2022/2023
Investimet totale	7,435,000	2,860,000
Makineri	4,895,690	975,000
Objektet punuese	1,250,970	895,000
Dhomat e ftohjes	204,480	75,000
Ndërtimi i kapaciteteve humane	72,460	510,000
Tjera	6,000	




# 5. KONKURRENCA NË SEKTOR DHE AKTIVITETET PROMOVUESE

## 5.1 Konkurrenca lojale kundrejtë asaj ndërkombëtare


Është evidente se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë, në tërë botën funksionon më së miri. Ekonomia e Republikës së Kosovës ka kaluar nga një ekonomi e planifikuar, në një ekonomi të tregut, duke synuar rritjen e kapaciteteve eksportuese e rrjedhimisht uljen e deficitit tregtar (AKK, 2020).

Produktet vendore vazhdojnë të përballen me konkurrencë të ashpër nga produktet e importit. Megjithatë, pasi Kosova ka regjim të lirë të tregtisë, është e vështirë të krijohet ndonjë strategji ose politikë që favorizon produktet vendore në krahasim me ato të importit. Mundësia kryesore e bizneseve kosovare është të përgatiten për një konkurrencë të ashpër, por edhe për një treg më të madh. Sikurse edhe në vendet e tjera të tranzicionit liberalizimi i tregtisë së jashtme u shoqërua me shpërpjesëtime të mëdha ndërmjet eksportit dhe importit, që shihet edhe nga të dhënat e paraqitura.

**FIG.10 Natyra e konkurrencës**



**FIG.11 Format e konkurrencës**



Në pyetjen që ju kemi drejtuar kompanive lidhur me konkurrencën, 63 % e tyre kanë deklaruar që ka konkurrencë të ashpër, 23 % nuk ndejnë konkurrencë dhe 14 % ka konkurrencë në kuadrin normal të tregtisë. Sa i përket natyrës së konkurrencës, 64 % e kompanive kanë deklaruar që konkurrenca është edhe nga kompanitë vendore dhe atyre ndërkombëtare, 27 % konkurrencën e vërejnë vetëm nga kompanitë ndërkombëtare dhe vetëm 9 % i konsiderojnë rival kompanitë vendore.

Rritja e konsumit vendor duhet të bëhet përmes edukimit të konsumatorëve. Për të pasur rritje të konsumit të produkteve vendore, prodhuesit vendor duhet të investojnë gjithnjë e më shumë në përmirësimin e kualitetit të produkteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë. Andaj nevojitet një mbështetje e vazhdueshme e organeve qeveritare për t'u lehtësuar prodhuesve investimet përkatëse të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e cilësisë dhe pasurimin e ofertës së plasuar në treg si dhe të ketë vazhdimësi të kampanjave edukative dhe vetëdijësuese mbi rëndësinë e konsumimit të produkteve vendore (Hollaj & Ahmetaj, 2018).

## 5.2 Pengesat kryesore në sektor

Rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit ka përshtatja e ndryshimeve strukturale, e mundësive dhe e kushteve të zhvillimit të bazuara në kërkesat e tregut për produktet dhe shërbimet e realizuara. Zhvillimi i industrisë së ushqimit dhe resurset natyrore janë të një rëndësie të veçantë në këtë drejtim. Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve në Kosovë i cili përqëndrohet kryesisht në përpunimin e lëndëve të para është duke pësuar rritje të dukshme sidomos viteve të fundit. Momentalisht ky sektor është në gjendje të mbulojë nevojat e brendshme me produkte si dhe kohëve të fundit ka filluar të rritet dukshëm edhe eksportimi i këtyre produkteve në disa shtete fqinje si: Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe në shumë vende Evropiane si: Austria, Gjermania, Zvicra, Suedia etj.

Si ne çdo sektor edhe sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve haset me vështirësi dhe problematika nga më të ndryshmet, kjo më së shumti si pasojë e zinxhirit të thyer të vlerave. Drejtuesit e bizneseve gjatë intervistimit janë shprehur që më së shumti vështirësi hasin në proceset si në vazhdim:

### a) Kultivimi i lëndës së parë dhe procesi i furnizimit:

Në Kosovë produktet më të shpeshta të cilat fitohen nga procesi i përpunimit të pemëve dhe perimeve janë: ajvari, turshitë, xhemat, reçeli. Prandaj si lëndë të para më të përdorurat janë: specat, karrotat, kastravecët, lakra, vishnje, molla, frutat e imëta etj. Disa nga përpunuesit kanë plantacionet e tyre me lëndë të pare mirëpo shumica (sidomos njësitë përpunuese të mëdha) duhet të sigurojnë lëndën e parë nga prodhues të ndryshëm.

Ndonjëherë gjetja e lëndës së parë paraqet vështirësi në vete pasi që operatorët e grumbullimit formojnë një hartë shumë të pabarabartë shpërndarjeje të produkteve nga fermat në fushë të hapur/serrat tek përpunuesit, me një model të përafërt mbizotërues të fermerëve të vegjël të cilët i shpërdajnë prodhimet e tyre direkt tek përpunuesit (duke përdorur mjetet e tyre të transportit dhe paketimit). Për sa i përket procesit të furnizimit, edhe pse përpunuesit kryesisht furnizohen me lëndë të pare nga prodhuesit vendor (rreth 85 - 90%) në disa raste përpunuesit hasin vështirësi në gjetjen e furnitorëve (lokal) të lëndëve të para pasi që kërkesa ndonjëherë është më e lartë, prandaj përpunuesit duhet të furnizohen me lëndë të parë nga importi (rreth 10 -15 %) (Bagaviki, 2014).

## **b) Mungesa e stafit të kualifikuar:**

Mungesa e stafit të kualifikuar për punë të ndryshme në zinxhirin e prodhimit është një ndër problematikat kryesore të këtij sektori. Siç është cekur në më lartë sipas drejtuesve të njësive përpunuese ky sektor ka mungesë të stafit të kualifikuar në këto fusha: teknolog ushqimor, inxhinier i makinerisë, laborant, menaxher i shitjes.

## **c) Tregu i fragmentuar:**

Shumica e produkteve të përpunuara kanë një shitje sezonale p.sh ajvari dhe turshitë kanë shitjen më të lartë gjatë sezonës vjeshtë/dimër, mirëpo gjatë muajve të tjerë ka shume pak ose fare shitje. Kjo është një problematikë e cila vështirëson punën vazhdueshme të një njësie përpunuese, pasi që nëse nuk ka kërkesë nuk ka edhe prodhim. Rregullimi i luhatjeve të kërkesave sezonale të tregut është shumë i vështirë. Shitja në tregun vendor kufizohet nga tregu i vogël vendor. Numri i madh i prodhuesëve, si dhe importi paraqesin sfidën kryesore të kompanive vendore për shitjen e produkteve të tyre.

## **d) Konkurrenca:**

Konkurrenca në Kosovë në këtë sektor është mesatarisht e lartë pasi që një gamë të njejtë produktesh prodhohet nga pothuajse të gjithë përpunuesit e këtij sektori. Pra edhe përpunuesit e mëdhenjë edhe të vegjël prodhojnë të njëjtat produkte. Përpos konkurrencës ndërmjet përpunuesve vendor ka konkurrencë edhe me përpunuesit fqinjë pasi që produktet e tyre futen mjaft lehtë në Kosovë. Përpunues të ndryshëm konkurrojnë njëri me tjetrin dhe me furnizuesit e jashtëm, duke targetuar segmentet e njëjta të tregut me produkte të ngjashme dhe strategji të ngjashme të hyrjes në treg. Dhe kjo ndikon në uljen e konkurrueshmërisë së kompanive vendore.

## **e) Kontraktimet për eksport**

Globalizimi ka lejuar ekonomitë e vogla sikurse e Kosovës që të përmirësojnë prospektet e tyre nëse janë konkurruese dhe të integruara mirë në tregjet botërore ashtu që ato mund të përfitojnë nga madhësia e ekonomisë dhe të shesin prodhimet e tyre tek blerësit e huaj. Por ekonomia e Kosovës dhe tregu i saj i punës janë të penguar nga problemet e vazhdueshme dhe të thella strukturore.

Gjetja e kontraktuesve për eksport të produkteve jashtë vendit nuk është gjithmonë e lehtë. Mungesa e ekspertëve për legjislacionin dhe kornizat tregtare ka ndikuar tek prodhuesit vendorë të hasin në vështirësi në depërtimin në tregjet e huaja. Falë donatorëve disa prej përpunuesëve vendorë që kanë marr pjesë në takime si B2B, Panaire, Misione të shitjes etj. kanë arritur të krijojnë kontakte dhe kontrata me blerës ndërkombëtarë.



## 6. KONKLUZIONET

Pas një paraqitje të rezultateve të dala nga kjo anketë, është e rëndësishme të identifikojmë të gjeturat kryesore në bazë të të cilave do të ishte e rendit të dizajnohen politikat e ardhshme të qeverisë, bizneseve dhe aleancave biznesore në drejtim të promovimit të produkteve vendore.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga terreni, shumica e kompanive vazhdojnë të përballen me mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me përvojë (teknolog, teknikë laboratorësh, mirëmbajtje, agjentë shitjesh, etj.), dhe gjithashtu qasjes së kufizuar në burimet financiare (kreditë e investimeve, normat e interesit, kushtet e huasë, çështjet administrative, etj.). Sipas informacionit të mbledhur lidhur me punësimin në sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve, kompanitë vendore në vitin 2021 kishin të punësuar 2,043 të punësuar, prej të cilëve 1,211 apo afro 58.3 % ishin të punësuar me kohë të plotë dhe 852 apo 41.7 % të punësuar sezonal, 65 % e të punësuarëve janë të grup moshës 20 - 45 vjeçare. Sipas disa kompanive, fuqia punëtore edhe mund të gjendet në tregun e punës, mirëpo pagat e ulta dhe sezonaliteti i bujqësisë janë faktorë që të rinjtë nuk janë të fokusuar në këtë industri.

Ekziston një trend gjithnjë në rritje i prodhimit të pemëve dhe perimeve të përpunuara në Kosovë; vakuumi ndërmjet kapaciteteve përpunuese dhe sasive në fakt të përpunuara është duke u ngushtuar në mënyrë të vazhdueshme. Megjithatë, akoma niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve të instaluar është i ultë. Sipas të dhënave që kemi marrë nga kompanitë, kapacitete të instaluar janë rreth 41,770 t, objektet me temperaturë dhomë përfshijnë një hapësirë prej 26,958 m<sup>2</sup>, dhe objektet në temperaturë (-°C) rreth 20,535 m<sup>2</sup>. Shfrytëzimi i këtyre kapaciteteve nuk kalon normën 59 %. Disa prej arsyejeve të mos shfrytëzimit të kapaciteteve është mungesa e një zingjiri të rregullt të furnizimit me lëndë të parë dhe mungesa e bashkëpunimit mes kompanive. Në disa raste, kompanitë ankohen që kanë mungesë të kërkesës për të prodhuar produkte dhe si pasojë nuk shfrytëzojnë kapacitetet e instaluar, e në anën tjetër ka kompani që nuk arrijnë të përmbushë kërkesën e tregut për shkak të mungesës së kapaciteteve në kompani. Mungesa e formave të bashkëpunimit ka krijuar situatë të tillë, ku niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve variron nga 25 % deri në 95 %.

Anëtarët e PePeKo-së vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm socio – ekonomik për banorët dhe zonat rurale. Rreth 93 % e furnizimit me lëndë të parë vjen nga fermerët vendorë, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit të zonave rurale dhe përmirësimin e mirëqenies së banorëve. Nga të dhënat e mbledhura, besohet se në mënyrë direkt dhe indirekt janë përfshirë më shumë se 5,000 fermerë në të gjithë territorin e Kosovës në këtë sektor. Bazuar në të dhënat e terrenit 12 kompani vendore furnizohen 100 % me lëndë të parë nga Kosova, 5 kompani furnizohen me rreth 90 % - 95 %, 4 kompani me 80 - 85 % dhe vetëm një kompani furnizohet me më pak se 70 % nga lënda e parë vendore. Sasia e perimeve të mbledhura nga kompanitë përpunuese në vend për vitin 2021 ishte rreth 15,900 ton, ndërsa sasia e pemëve ishte 7,500 ton. Kompanitë e përpunimit, në varësi të llojit të kulturave bujqësore që mbledhin për përpunim, përdorin dy kanale kryesore furnizuese: direkt nga fermerët dhe indirekt, nga qendrat e grumbullimit të pemëve dhe perimeve. Për të kuptuar marrëdhëniet brenda zinxhirit të vlerave për pemët dhe perimet e përpunuara, është jetike që të hulumtohen akterët e ndryshëm dhe ndikimi i tyre direkt dhe i tërthortë në

zinxhirin e performancës. Përpunuesit vendorë në Kosovë bashkëpunojnë drejtpërdrejt me shitësit me pakicë dhe shumë pak me shitësit me shumicë

(PPSE, 2014). Kompanitë kanë deklaruar që kanë 415 kontrata tregtare me supermarketet, 331 kontrata me tregtarë me shumicë, 453 kontrata me tregtarë me pakicë, dhe 34 kontrata me distributorë.

Ekonomia e Kosovës përbënë një ekonomi dinamike dhe të re. Synimi i Kosovës është rritja e konkurreshmërisë së saj ekonomike duke rritur eksportin në mënyrë që të zvogëlohet deficitit tregtar që aktualisht e ka. Sipas të dhënave të grumbulluara nga intervistat e drejtpërdrejta, gjatë vitit 2021 kompanitë vendore kanë realizuar shitje rreth 35 milion euro, prej të cilave rreth 24.3 milion në tregun e brendshëm dhe 10.7 milion euro eksport. Nëse krahasojmë vitin 2021 me vitin 2019 dhe 2020, vërejmë që kemi rritje të shitjeve totale (shitjeve në vend dhe eksport). Në krahasim me vitin 2019 diferenca është rreth 11.24 %, ndërsa në krahasim me vitin 2020 diferenca është rreth 6.7 %. Vendet kryesore të eksportit janë: Gjermania, Zvicra, Italia, Austria, Finlanda, Suedia Belgjika, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kuvajti, si dhe ShBA-t. Produktet si turshit dhe ajvari kanë pasur pjesëmarrjen më të lartë si produktet më të eksportuara, pasuar nga lëngjet, xhemat dhe marmelatat. Viti 2021 për sektorin e përpunimit ka sjellur rritje ekonomike dhe rritje të eksportit. Kjo vërejtje si shkak i prishjes së zingjirit të furnizimit nga Azia, ku vendet e Europës kanë përdorur kanalet e furnizimit nga Kosova me pemë dhe perime të përpunuara.

Pavarësisht vështirësive ekonomike që ka sjellë pandemia, sektori i agroushqimit edhe për vitin 2021 ka pasur interes të lartë për investime. Gjatë këtij viti, vlera e investimeve në sektor ka kapur shumën rreth 7.4 milion euro. Nga shuma totale e investimeve rreth 65.8 % ka qenë në makineri, 16.8 % në objekte dhe qendra përpunuese, 2.75 % në hapësira ftohëse. Shqetësues mbetet fakti i ngritjes së kapaciteteve humane ku edhe këtë vit vetëm 1 % e shumës totale e investimeve ka qenë e destinuar në kualifikim dhe përgatitje të stafit të kompanive. Përmes granteve dhe mbështetjes institucionale, ky sektor është bërë vlerë për ekonominë e Kosovës. Nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtjes së atyre ekzistuese përmes zhvillimit të veprimtarive të përpunimit të pemëve dhe perimeve, duke rritur në këtë mënyrë nivelin e veprimtarive ekonomike të zonave rurale, duke rritur drejtpërsëdrejti të ardhurat e familjeve fermere dhe shmangur braktisjen e zonave rurale, duke kontribuar në një balancë më të mirë territoriale si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social.

Pasi Kosova ka ekonomi të lirë të tregut, ju ofron mundësi kompanive të shumta të qasen lehtësisht në tregun kosovar. Kjo ndikon në rritjen e konkurrencës tek prodhimet në Kosovë. Në pyetjen që ju kemi drejtuar kompanive lidhur me konkurrencën, 63 % e tyre kanë deklaruar që ka konkurrencë të ashpër, 23 % nuk ndjejnë konkurrencë dhe 14 % ka konkurrencë në kuadrin normal të tregtisë. Sa i përket natyrës së konkurrencës, 64 % e kompanive kanë deklaruar që konkurrenca është edhe nga kompanitë vendore dhe atyre ndërkombëtare, 27 % konkurrencën e vërejnë vetëm nga kompanitë ndërkombëtare dhe vetëm 9 % i konsiderojnë rival kompanitë vendore. Prej problemeve kryesore të sektorit janë kultivimi i lëndës së parë dhe procesi i furnizimit, mungesa e stafit të kualifikuar, tregu i fragmentuar, konkurrenca, kontraktimet për eksport.



## 7. REKOMANDIMET

► Politika e konkurrencës është një element i domosdoshëm i një tregu të lirë, që funksionon duke siguruar që të gjitha ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë në bazë të meritave të tyre (AKK, 2020). Liberalizimi tregtar është esencial në ndërtimin e një ekonomie të hapur dhe për forcimin e konkurrencës së ekonomisë vendore për t'u përballur me importin në tregun vendor dhe për të përmirësuar performansën e eksportuesve. Ekonomitë e vogla siç është Kosova duhet që, në veçanti, të kërkojnë mundësitë e tregut të lirë, ekonomisë së hapur dhe liberalizimit tregtar. Sidoqoftë, konteksti dhe procesi i liberalizimit duhet të diskutohen (Riinvest, 2010). Kosova, duhet të i kushtojë rëndësi krijimit të një sistemi për të promovuar konkurrencën e lirë dhe efektive, që t'i inkurajoj ndërmarrjet të rrisin efikasitetin dhe inovacionin, duke nxitur zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik, që konsumatori të përfitoj nga një treg konkurrues.

► Duhet të krijohet një politikë që ju jep mundësi për krijimin e hapësirës adekuate ekspozuese për prodhimet vendore në raftat e marketet, si dhe të nxitet respektimi i kontratave mes prodhuesëve dhe marketeve. Gjithashtu, sygjerohet që të ngriten kapacitetet e trupave inspektuese shtetërore për të inspektuar situatën në treg për produktet ushqimore në mënyrë të menaxhimit dhe zbatimit të sigurisë ushqimore për konsumatorët kosovar. Sa i përket organizimit të tregut me produkte vendore kompanitë vendore duhet të ju kushtojnë rëndësi kampanjave vetëdijësuese dhe të investojnë në marketing strategjik, në mënyrë që të nihen nevojat dhe preferencat e konsumatorëve. Roli institucional në këtë çështje është zhvillimi i një qasje më strategjike nga niveli qeveritar dhe lokal për t'a promovuar konsumimin e produkteve vendore.

► Mungesa e kuadrove të specializuara për profile të caktuara në sektor si: teknolog i ushqimit, teknik laborator, inxhinier i makinerise etj. vjen si pasojë e mungesës së investimeve në burime njerëzore dhe mungesës së koordinimit midis kërkesës së tregut për profilet profesionale të punëtorëve dhe programeve të institucioneve arsimore publike dhe private. Ky boshëllëk mund të zvogëlohet nëse kompanitë rrisin investimet në burimet njerëzore dhe nga ana tjetër, qeveria duke krijuar skema të mbështetjes dhe koordinimit midis kërkesës së tregut për profilet profesionale të punëtorëve dhe programeve të institucioneve arsimore publike dhe private në mënyrë që të plotësojë këtë boshllëk. Poashtu është i nevojshëm koordinimi më i mirë midis institucioneve arsimore që përfshijnë në kurikulat e tyre bujqësinë, teknologjinë ushqimore, inxhinierinë mekanike si Universitetet (p.sh Universiteti i Prishtinës, Universiteti Haxhi Zeka, Universiteti Isa Boletini), Shkollat e Mesme si dhe dhe agjencitë e ndryshme arsimore në mënyrë që të plotësohet hendeku midis kërkesës për profile të caktuara në njërin anë, dhe punësimi i të rinjve të diplomuar nga universitetet dhe shkollat e mesme në anën tjetër. Këta hapa do të ndikonin në uljen e hendekut midis kërkesave për profile profesionale dhe të diplomuarve të papunë.

► Duke marrë parasysh që shumica e kompanive eksportuese kanë si synim tregun e BE-së, standardet e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit kërkohen të implementohen nga kompanitë. Ato duhet të investojnë më shumë në zbatimin e standardeve të cilat janë të detyrueshme ose vullnetare si HACCP, ISO 22000, IFS, BRC, etj.

- ▶ Përpos këtyre standardeve trendi i ri Evropian mbi kultivimin e lëndës së parë dhe produkteve finale BIO (Standardi EEC 834/2007) është njëri nga standardet me anë të të cilit kompanitë e certifikuar do të mund të konkurronin denjësisht në një treg ndërkombëtar. Kjo mund të jetë lehtë e arritshme pasi që moti i ngrohtë dhe klima e favorshme e bëjnë Kosovën një burim ideal të prodhimit të lëndës së parë organike, duke pasur parasysh edhe tokën pjellore. Për të konkuruar në treg ndërkombëtar ku fuqia blerëse janë mjaft mirë të informuar dhe janë të orientuar drejt cilësisë së produktit, fermerët Kosovarë duhet të marrin masat e duhura për të përmbushur kërkesat, duke certifikuar produktet e tyre.
- ▶ Duke pasur parasysh që panairët e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare (p.sh AGRO-KOS, Panairi i Grave Rurale, ANUGA, SIAL Paris etj) dhe takimet B2B kanë treguar rezultat në gjetjen e blerësve dhe partnerëve të rinjë të mundshëm, aktivitetet promovuese të tilla duhet të vazhdojnë edhe në vijim, duke pasur edhe mbështetjen nga institucionet vendore dhe agjencitë lokale si KIESA.
- ▶ Fokus tjetër i institucioneve vendore është ngritja e pikave të grumbullimit, në mënyrë që furnizimi me lëndë të parë të jetë i rregulltë. Për të shmangur problemet me furnizimin e lëndëve të para për shkak të mosrespektimit të marrëveshjeve kontraktuale ndërmjet palëve kontraktuese, kontraktimi i noterizuar duhet të promovohet në mënyrë që palët të bien dakort paraprakisht për çmimet e produkteve, sasinë e furnizuar/ marrjes dhe aspekte të tjera të rëndësishme të kontraktimit në mënyrë që furnizimi me lëndë të parë të mos mungojë. Ministria e Bujqësisë, duhet të luaj rol nxitës dhe aktiv në krijimin edhe të kooperativave si forma të përbashkëta organizimi të fermerëve dhe prodhuesëve.
- ▶ Avokimi si një instrument për të kanalizuar problemet e sektorit dhe për t'i adresuar ato në institucionet e duhura duhet të jetë një aktivitet i vazhdueshëm. Prandaj, politikëbërësit dhe akterët tjerë të interesuar duhet të i trajtojnë këto vështirësi, në mënyrë që të përmirësohet zhvillimi i sektorit. Shoqata PePeKo, së bashku me anëtarët e saj do të vazhdojnë të ngrisin zërin sidomos karshi problematikave që i hasin në përditshmëri lidhur me: furnizimin me lëndë të parë, mungesën e tregjeve stabile, gjetjen e kuadrove etj. për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin të politikave shtetërore për sektorin e agro ushqimor. Gjithashtu, Shoqata PePeKo do të i kushtoj rëndësi ngritjes së çështjes së rolit dhe pozitës së grave dhe grupeve të marginalizuara në bujqësi.

# LITERATURA

- ▶ *Agjencia e Statistikave të Kosovës-ASK, 2021. Bruto Produkti Vendor 2008-2018, Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.*
- ▶ *Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, 2020. Strategjia 2020 - 2023, Prishtinë: Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.*
- ▶ *Bagaviki, R., 2014. 'Studim i Sezonalitetit të Nën-Sektorëve të Agropërpunimit dhe Potencialit për Kreditim, nga Perspektiva Gjinore, Tiranë: s.n.*
- ▶ *Hodaj, N., 2016. Bujqësia, vendi dhe roli i saj në ekonominë vendore, Tiranë: s.n.*
- ▶ *Hollaj, L. & Ahmetaj, G., 2018. Konsumimi i produkteve vendore në Kosovë, Prishtinë: Riinvest.*
- ▶ *Ilijazi, E. M., Dhima, S., Shehaj, A. & Poisson, G., 2017. Analiza nënsektorit të parë, Tiranë: s.n.*
- ▶ *Karl, C. M. d., 2014. Udhëzues për eksportues, Prishtinë: UNDP.*
- ▶ *MAFRD, 2020. Kosovo Green Book- Agriculture and Rural Sustainable Development, Prishtinë: Ministry of Agriculture Forestry and Rural.*
- ▶ *Oda Ekonomike Amerikane, 2018. Arsimi dhe Tregu i Punës në Kosovë dhe Bashkim Evropian, Prishtinë: Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.*
- ▶ *PPSE, 2014. Produktet e pemëve dhe perimeve të përpunuara në Kosovë, Prishtinë: PPSE.*
- ▶ *Riinvest, 2003. Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë, Prishtinë: Riinvest.*



- ▶ Riinvest, 2010. *Politika tregtare dhe promovimi i eksportit në Kosovë, Prishtinë: Riinvest.*
- ▶ Riinvest, 2018. *Tregu i punës dhe papunësia në Kosovë, Prishtinë: Riinvest.*
- ▶ Sawant, A., Sordillo, L. & Jayarao, B., 2005. *A survey on antibiotic usage in dairy herds. Journal of Dairy Science, 88(8), pp. 2991-2999.*
- ▶ Zhitia, E., 2017. *Animal welfare assessment and potential strategies to improve dairy cattle welfare in Kosovo, Vienna: University of Natural Resources and Life Sciences.*





